





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj  
Opština Skenderaj  
Municipality of Skenderaj

## DËGJIM BUXHETOR ME PËRFAQËSUESIT E BIZNESEVE DHE FERMERËT E KOMUNËS SË SKENDERAJT PËR KAB 2025-2027

Salla e Kuvendit Komunal Skenderaj  
Më 07.06.2024, ora 14.30

### Ekstrakt i procesverbalit

**Drejtori për Buxhet dhe Financa, Ismet Aliu:** Përshendetje për të gjithë. Sqaron procesin e hartimit të buxhetit dhe rëndësinë e dëgjimit buxhetor. Fton pjesëmarrësit që të i parashtronë kërkesat e tyre.

**Kryetari i Komunës, Fadil Nura:** Përshendetje! Mirë se keni ardhë. Ky është dëgjimi i dytë për KAB. Dëgjimet buxhetore janë shumë të rëndësishme në hartimin e buxhetit. Kërkoj nga ju që të i parashtroni kërkesat e juaja në mënyrë që të i përfshijmë në buxhet, prandaj jeni të lirë ta merrni fjalën.

**Drejtori për Buxhet dhe Financa, Ismet Aliu:** jeni të lirë të e merrni fjalën dhe të i parashtroni kërkesat e juaja, të cilat në bazë të mundësive do të i përfshijmë në buxhet.

**Armend Bajraktari:** Klinë e Epërme, jam fermer, gjithashtu jam edhe anëtar i Shoqatës së Qumështit. Në emër tim dhe në emër të Shoqatës kërkoj subvencionimin e qumështit. Këtë kërkesë e kemi parashtruar edhe vitin e kaluar.

**Drejtori i Bujqësisë, Behgjet Maliqi:** faleminderit, në bazë të rregullativës ligjore nuk mund të iu subvencionojmë. Edhe komunat që e kanë praktikë subvencionimin e qumështit e kanë ndërpre subvencionimin e qumështit. Ajo çka mund të bëjmë është përkrahja e qumështarëve nëpërmjet subvencioneve me mekanizma bujqësor për të fuqizuar këtë sektor.

**Armend Bajraktari:** vetëm Mitrovica e ka ndërpre subvencionimin e qumështit. Kërkojmë nga ju të na tregoni se a është i ligjshëm ky subvencionim dhe a mund të na subvenciononi, apo jo?

**Drejtori i Bujqësisë, Behgjet Maliqi:** është e jashtëligjshme. Fermerët e qumështit janë serioz dhe kërkojmë mirëkuptim, por do të iu përkrahim në mënyra tjera.

**Ismet Aliu:** faleminderit për pjesëmarrje dhe meqenëse nuk ka të interesuar e mbylli këtë takim.

Procesmbajtësi: Albert Rexhepi

